


24/02/2025

KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË SOLIDARIZOHET DHE LUTET PËR SHËRIMIN E PAPA FRANÇESKUT.



Kryetarit të Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, Ipeshkvit të Rrëshenit, Imzot Gjergj Meta,

Shkëlqesia juaj,

Në emër të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, pas lajmit për sëmundjen e Shenjtërisë së Tij Papa Françeskut, shprehim solidaritetin tonë dhe lutemi që Perëndia i Tërëmirë, në këto momente sprove, t'i japë shërim të shpejtë dhe të plotë për të vazhduar misionin e Tij të rëndësishëm për Kishën Katolike dhe besimtarët e saj në mbarë botën.

“O Zot, Perëndia im, unë të kam thirrur në ndihmë dhe ti më ke shëruar” (Psalmi 30:2).

Tiranë, 24 shkurt 2025

Me respekt dhe dashuri vëllazërore në Krishtin,

†Joani

Mitropolit i Korçës

Mbikqyrës i Kryepiskopatës së Hirshme

të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)